



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Niveli i pagave në Kosovë 2022





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Niveli i pagave në Kosovë 2022



Hyrje

Ky raport është hartuar në bazë të kërkesës dhe nevojës nga shfrytëzuesit, përfshirë institucionet shtetërore dhe shfrytëzuesit e ndryshëm. Të dhënat e prezantuara në këtë raport janë të dhëna, që do t'u ndihmojë vendimmarrësve në orientimin e politikave të tyre dhe në planifikimin e mënyrave më efektive në mbajtjen dhe motivimin e punonjësve.

Niveli i pagës është një e dhënë e rëndësishme, jo vetëm për organizatat, që e shfrytëzojnë si bazë për të bërë ndryshime (rritje/ulje), por njëherit është edhe tregues shumë i rëndësishëm për investitorët e rinj dhe çelës apo instrument tërheqës për të marrë kandidatë më të mirë.

Kur një organizatë është e përbërë nga njerëz të aftë dhe të motivuar nuk mungojnë edhe sukseset. Strukturat e pagave janë pjesë e domosdoshme e menaxhimit efektiv por janë edhe faktorë bazë dhe shtytës të zhvillimeve. Për qasje më të lehtë të shfrytëzuesëve, në këtë raport është dhënë paga mesatare bruto dhe neto.

Te të dhënat e sektorit privat nuk janë të përfshira shtesat në pagën mujore sepse ato përfshihen në deklaratën vjetore si qarkullim. Derisa tek sektori publik (pagat të cilët paguhen nga Buxheti i Republikës së Kosovës) vërehet një rënie e pagës bruto dhe neto krahasuar me vitin 2020, e cila ka ardhur për arsye të përfitimit të shtesave në sektorët specifik për shkak të Pandemisë Covid-19 në vitin 2020.¹

Raporti përmban të dhënat për vitin 2022 derisa janë paraqitur të dhënat edhe për vitet 2012-2022 si qasje e vazhdueshme. ASK-ja planifikon që ti publikojë rregullisht të dhënat për pagën mesatare në nivelin më të ulët edhe sipas sektorëve ekonomikë.

Ndarja e nivelit të pagave është bërë për tre (3) sektorët si me poshtë:

- Sektorin Publik (Administrata),
- Sektorin Privat, dhe
- Ndërmarrjet publike

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja, lidhur me këtë publikim, janë të mirëseardhura dhe mund të dërgohen në adresën elektronike: social@rks-gov.net

Publikimin e përgatitën:

Avni Kastrati	-	Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale/Popullsisë
Naime Rexhepi	-	Shefe e Divizionit të Statistikave Sociale
Bujar Hajrizi	-	Shef i sektorit të statistikave të punësimit
Guxim Neziri	-	Zyrtar i TI-së për RSB-s
Shpetim Bullatovci	-	Zyrtar i Tregut të Punës.
Besarta Thaçi	-	Zyrtare e Tregut të Punës.

Z.V. i Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së
Ilir T. Berisha

¹ Ndikimi i pandemisë në pagat bruto dhe neto në Republikën e Kosovës

Shkurtesat

ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës
ISCO	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Profesioneve
MAP	Ministria e Administratës Publike
NACE	Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike
RSB	Regjistri Statistikor i Bizneseve

Hyrje	4
Përmbajtja	6
Definicione.....	7
Burimi i të dhënave dhe metodologjia.....	8
Saktori publik.....	9
Saktori privat	8
Ndërmarrjet publike.....	8
Niveli i pagës mesatare në Kosovë.....	9
Paga mesatare sipas saktoreve në Kosovë.....	10
Saktori publik.....	10
Ndërmarrjet publike.....	10
Saktori privat	11
Pagat mesatare bruto sipas saktoreve	12
Paga mesatare neto sipas saktoreve.....	12
Paga minimale në Kosovë	14
Paga mesatare bruto dhe neto sipas aktiviteteve ekonomike	14

Definicione

Paga bruto	Të ardhurat bruto të punonjësve, që përfshinë të ardhurat për punën dhe kohën e kaluar në punë, të ardhurat e tjera personale, të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje kolektive (shtesat), ose kontratën e punës, në të cilën tatimi mbi të ardhurat personale është zbatuar. Ndryshe, paga bruto është shuma e përgjithshme e pagës pa tatim dhe pa kontributet e zbritura (pension/kursime pensionale, sigurime shëndetësore, etj.).
Paga neto	Pagat neto janë tatimi dhe kontributet e zbritura nga paga bruto.
Spektori publik	Të gjithë të punësuarit, të cilët marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës janë përfshirë në sektorin publik.
Spektori privat	Të gjithë të punësuarit, të cilët punojnë pranë ndërmarrjeve private (bizneset private), për të cilët ndërmarrjet paguajnë taksat dhe kontributet e tyre.
Ndërmarrjet publike	Ndërmarrjet publike përfshijnë të gjitha ndërmarrjet, që janë në pronësi publike, ose janë themeluar me fonde publike, ose sipas ligjit publik dhe nuk janë autoritete publike, ose pjesë të autoriteteve publike.

Burimi i të dhënave dhe metodologjia

Sektori publik

Burimi i të dhënave: të dhënat për sektorin publik janë nxjerrë nga MF/Thesari - Divizioni i Administrimit të Pagesave/lista e pagesave të pagave për pagën bruto dhe neto. Numri i marrësve të pagave në sektorin e Buxhetit të Republikës së Kosovës (BRK) si mesatare vjetore 2022 ishte 83 046 persona².

Metoda e llogaritjes së pagës mesatare vjetore/sektori publik: Kalkulimi i pagës mesatare vjetore për sektorin publik është bërë sipas formulës:

$$\bar{x} = \frac{\sum_{i=1}^n x_i}{n} = \frac{x_1 + x_2 + \dots + x_n}{n}$$

$\bar{x}$	prezanton simbolin për mesataren aritmetike të mostrës
n	është numri total i vrojtimeve- elementeve
x	prezanton vlerat individuale
Σ	prezanton shumën e përgjithshme të vlerave

Sektori privat

Burimi i të dhënave: të dhënat për sektorin privat janë nxjerrë nga Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB), që përmban të dhëna për të gjitha ndërmarrjet (publike dhe private), që ushtrojnë aktivitetin ekonomik brenda territorit të Kosovës. Kjo përfshinë të gjithë sektorët ekonomikë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NACE Rev.2. Nuk përfshinë Administratën Publike, Organizatat Jo-Fitimprurëse dhe Organizatat Ndërkombëtare.

Burimet për azhurnimin e variablave të RSB-së janë: Burimet administrative (informacionet nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë dhe nga Administrata Tatimore e Kosovës), si dhe burimet statistikore (Anketa për Azhurnimin e RSB-së, Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve dhe Anketat për Statistikat Afatshkurtra).

Ndërmarrjet publike

Burimi i të dhënave: të dhënat për ndërmarrjet publike janë nxjerrë nga Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB), baza e njëjtë si të sektori privat.

²Në mesataren e pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës (BRK), është përfshirë edhe fondi i kuadrove (shitesat).


Niveli i pagës mesatare në Kosovë

Në vitin 2012, paga mesatare bruto në Kosovë ishte 383 Euro, derisa në vitin 2021 ishte 484 Euro, ndërsa në vitin 2022 kemi rritje në 521 Euro, pra me një rritje me 37 Euro nga viti paraprak. Derisa, paga neto nga 348 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 432 Euro në vitin 2021, ndërsa vitin 2022 kemi rritje në 446 Euro, pra me një rritje prej 14 Euro nga viti paraprak.

Tab. 1: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto (në Euro), sipas viteve 2012 - 2022

Viti	Kosovë		Sektori Publik		Ndërmarrjet Publike		Sektori Privat	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto
2012	383	348	407	366	561	502	337	308
2013	386	351	411	370	573	512	340	310
2014	403	365	473	423	656	583	329	301
2015	415	376	509	454	674	598	328	300
2016	422	382	525	467	686	609	340	310
2017	431	390	532	474	699	620	356	324
2018	453	409	573	509	721	639	376	342
2019	477	430	584	519	766	677	411	372
2020	466	416	624	552	769	680	380	342
2021	484	432	612	542	768	680	419	376
2022	521	446	604	536	789	659	473	401

Graf. 1: Paga mesatare bruto dhe neto (në Euro) sipas viteve 2012-2022




Paga mesatare sipas sektorëve në Kosovë

Sektori publik

Paga mesatare bruto në sektorin publik në vitin 2012 ishte 407 Euro, derisa në vitin 2022 ishte 604 Euro, duke u rritur për 197 Euro, ose 48.4%. Derisa, paga neto nga 366 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 536 Euro, një rritje prej 170 Eurosh, ose 46.4%.


Graf. 2: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto (në Euro) në sektorin publik, 2012-2022



Ndërmarrjet publike

Paga mesatare bruto te ndërmarrjet publike, në vitin 2012 ishte 561 Euro, derisa në vitin 2022 ishte 789 Euro, që u rrit për 228 Euro, ose 40.6%. Derisa, paga neto nga 502 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 659 Euro, një rritje prej 157 Eurosh, ose 31.3%.


Graf. 3: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto (në Euro) në ndërmarrjet publike, 2012-2022



Sektori privat

Paga mesatare bruto në sektorin privat, në vitin 2012 ishte 337 Euro, derisa në vitin 2022 ishte 473 Euro. që u rrit për 96 Euro, ose 25.5 %. Derisa, paga neto nga 308 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 401 Euro, një rritje prej 93 Euro, ose 30.19%.


Graf. 4: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto (në Euro) në sektorin privat, 2012-2022



Pagat mesatare bruto sipas sektorëve

Niveli i pagave më të larta në Kosovë ishte te ndërmarrjet publike. Në vitin 2012, te ndërmarrjet publike, paga mesatare bruto ishte 561 Euro, derisa në vitin 2022 arriti në 789 Euro. Sektori publik, në vitin 2012, kishte një pagë mesatare bruto 407 Euro dhe në vitin 2022 një pagë mesatare 604 Euro. Sektori privat ishte sektori me pagën më të ulët mesatare bruto dhe me një rritje shumë të vogël. Ky sektor, në vitin 2012 kishte një pagë mesatare 337 Euro, derisa në vitin 2022 kishte një pagë mesatare 473 Euro.


Graf. 5: Niveli i pagave mesatare bruto (në Euro) sipas sektorëve, 2012-2022



Paga mesatare neto sipas sektorëve


Te ndërmarrjet publike, paga mesatare neto, në vitin 2012, arrinte nivelin 502 Euro, derisa në vitin 2022 arrinte në 659 Euro. Sektori publik, në vitin 2012, kishte një pagë mesatare neto 366 Euro dhe në vitin 2022 një pagë mesatare neto prej 536 Eurosh. Sektori privat, në vitin 2012, kishte një pagë mesatare neto 308 Euro, derisa në vitin 2022 kishte një pagë mesatare 401 Euro.

Graf. 6: Niveli i pagës mesatare neto (në Euro) sipas sektorëve, 2012-2022



Jo të gjithë sektorët patën rritje të shprehur të pagave nëpër vite. Në sektorin publik, paga bruto, për periudhën 2012-2022, u rrit për 197 euro. Te sektori privat, kishte vetëm një rritje prej 136 Eurosh, brenda periudhës në fjalë, nga 337 në 473 Euro. Te ndërmarrjet publike, pati rritje më të madhe me 228 Euro më shumë se viti 2012.

Graf. 7: Rritja e pagës mesatare bruto dhe neto (në Euro) sipas sektorëve, 2012-2022



Paga minimale në Kosovë

Norma e pagës minimale është paga më e ulët e lejuar, zakonisht e rregulluar përmes ligjeve shtetërore. Në Kosovë, aktualisht paga minimale është e kategorizuar në 130 Euro për të punësuarit deri në moshën 35-vjeçare dhe 170 Euro për të punësuarit mbi moshën 35-vjeçare.

Tab. 2: Raporti i pagës minimale me pagën mesatare bruto dhe neto (në Euro) në Kosovë, 2022

Grupmosha	Paga minimale	Bruto (%)	Neto (%)
Deri në moshën 35-vjeçare	130	24,95	29,15
Mbi moshën 35-vjeçare	170	32,63	38,12

Paga mesatare bruto dhe neto sipas aktiviteteve ekonomike


Indikator mjaft i rëndësishëm është edhe paga bruto dhe neto sipas aktiviteteve ekonomike në Kosovë. Paga mesatare bruto në vitin 2022 sipas aktiviteteve ekonomike më e lartë ishte te: Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 968 euro, pastaj Informim dhe komunikim me 896 euro, derisa paga më e ulët ishte tek Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 323 euro.

Paga mesatare neto në vitin 2022 sipas aktiviteteve ekonomike ka të njëjtën renditje si më lartë me: Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 804 euro, pastaj Informim dhe komunikim me 745 euro, derisa paga më e ulët ishte tek Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 277 euro.

Tab. 3: Paga mesatare (në Euro) sipas aktiviteteve ekonomike në Kosovë, 2022

Aktivitetet ekonomike		Paga mesatare	
		Bruto	Neto
A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	351	299
B	Xehetari dhe gurëthyes	585	492
C	Prodhim	409	348
D	Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	968	804
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	554	467
F	Ndërtimtari	444	376
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve dhe motoçikletave	449	381
H	Transporti dhe magazinimi	483	410
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	323	277
J	Informim dhe komunikim	896	745
K	Aktivitete financiare dhe të sigurimit	544	469
L	Aktivitete të patundshmërisë	481	407
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	580	486
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	564	473
O	Administratë publike dhe mbrojtja, sigurimi social i detyrueshëm	659	585
P	Arsim	506	448
Q	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	633	548
R	Art, zbavitje dhe rekreacion	508	431
S	Aktivitete të shërbimeve tjera	336	287

Graf 8: Rritja e pagës mesatare bruto dhe neto (në Euro) sipas aktiviteteve ekonomike, 2022



Agjencia e statistikave te Kosoves: Përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrit të Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese; Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;* Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj.

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41 Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

Adresa:

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

Telefoni:

+383 (0) 38 200 31 129

Kryeshefi Ekzekutiv:

+383 (0) 38 200 31 112

Fax:

+383 (0) 38 235 033

E-mail:

infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe:

<http://ask.rks-gov.net>